

FATMIRA MUSAJ

**GRUAJA NË SHQIPËRI NË VITET
E LUFTËS SË PARË BOTËRORE
(1915-1918)***

Pas Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare deri në fillim të Luftës së Parë Botërore, gjendja e gruas në Shqipëri nuk njohu ndonjë ndryshim. Në pozitën e saj reflektohej prapambetja ekonomike, shoqërore e kulturore e vendit të sapodalë nga sundimi osman. Parë në tërësi gjendja e saj në vitet 1915-1918, u rëndua edhe më shumë.

Fuqitë e Mëdha të dy blloqeve ndërluftuese, gjatë këtyre viteve, shkelën vendimin e Konferencës së Londrës të vitit 1913, mbi garancinë për asnjësinë e shtetit shqiptar dhe shtrinë pushtimin në të gjithë sipërfaqen e vendit, duke larguar prej tij ushtritë pararendëse, serbe e greke. Gruaja shqiptare pas përjetimit të vrasjeve, përdhunimeve, shpërnguljeve me dhunë të shkaktuara nga ushtritë e shteteve fqinje, fillimisht ashtu si pjesa tjetër e shoqërisë, i mirëpriti ushtritë aleate dhe ato të Fuqive Qendrore. Nuk u shënua ndonjë konflikt me popullsinë vendase lidhur me sjelljen karshi grave, për shkak të qëndrimit korrekt të trupave ushtarake, të cilat respektonin deklaratat e shpallura nga fuqitë ndërluftuese se do të respektonin ndjenjat e shqiptarëve¹. Por në vitet e pushtimeve të huaja, fanatizmi dhe konservatorizmi që ekzistonte në shoqëri për gruan, jeta e mbyllur për pjesën më të madhe të popullsisë, kryesisht të besimit islam, u theksuan më shumë. Kjo evidentohet edhe në ditarin e ushtarit Jean-Louis Beaufils, pjesë e ushtrisë franceze që kishte pushtuar zonën e Pogradecit dhe të Korçës, i cili gjatë qëndrimit në shtëpinë e një fshatari, konstatoi se gratë rrinin të veçuara nga burrat. “Nga pëshpërimat dhe lëvizjet nëpër shtëpi,-theksonte ai,- kuptojmë se këtu banojnë gra, nëna me dy vajzat e saj, por ne sillemi sikur ato të mos ekzistojnë dhe babait të tyre i vjen mirë nga kjo sjellje. Ne i respektojmë gjërat e tyre, fenë”².

¹ Mit'hat Frashëri. *Çështja e Epirit*, Tiranë: Lumo Skëndo, 1998, f. 84.

² Luan Rama, *Bonjour D'Albanie, Shkrime nën hijen e bombave*, Les Livres Rama, Paris: 2014, f. 195-196.

Pjesa më e madhe e sipërfaqes së vendit u pushtua nga ushtritë austro-hungareze, duke u pasuar në juglindje dhe jugperëndim nga ato franceze dhe italiane. Komanda e Përgjithshme austro-hungareze e vendosur në Shkodër nisi punën për organizimin e administratës civile. Të njëjtën politikë ndoqën edhe kundërshtarët e tyre në pjesët e tjera të territorit shqiptar.

Dokumente arkivore austro-hungareze, dëshmojnë se jo çdo gjë shkoi mrekullisht midis forcave të pushtimit dhe popullsisë. Qysh në muajt e parë komanda austro-hungareze, në kuadrin e nevojave të ushtrisë, ndërmoi disa masa, të cilat ranë ndesh me doket, zakonet dhe besimet fetare të vendasve. Kryesisht ato kishin të bënin me strehimin e ushtarëve dhe rekuizimet për nevojat e ushtrisë.³ Vendimi për strehimin e ushtarëve në zonat e banuara në qytetin e Shkodrës, shqetësoi klerin mysliman. Popullsia e këtij besimi ishte në numër më të madh sesa pjesa katolike. Mbulimi dhe veçimi i gruas myslimane ndaj pjesës mashkullore, luante për të edhe rolin mbrojtës ndaj pushtuesve të huaj. Për këtë arsye, kleri i drejtoi një letër ankesë konsullit të përgjithshëm austro-hungarez Kral, ku ndër të tjera i kërkoi anulimin e vendimit për strehimin e ushtarëve në zonat e banuara, sepse ai binte ndesh me ligjet fetare që urdhëronin veçimin e grave nga burrat muhamedanë. Njëkohësisht në letër kundërshtojë edhe vendimi për krijimin e shtëpive të rinisë në qytet⁴. Mesa duket kleri bënte kujdes për të ruajtur rininë nga ndikimet e huaja. Ai mbajti të njëjtin qëndrim në vitin 1918, edhe ndaj vendimit të kësaj komande për ndalimin e lëvizjes së grave me perçe në vende publike.⁵ Gjithashtu u kërkua që ushtritë dhe mjetet e tyre të bënin kujdes që të mos shkelnin në arat e mbjella.⁶

Të njëjtën pozitë në shoqërinë shqiptare zinte gruaja edhe në zonat lindore dhe juglindore të Shqipërisë. Kjo pasqyrohet thukët në ditarët e ushtarakëve francezë, të cilët vërenin se Turqia kishte lënë ngado zakonet

³ *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSStA.PA.A*), në *Arkivin e Institutit të Historisë*, (më tej: *AIH*), Vj. 26.17.1776, Relacion i konsullit të përgjithshëm të Austro-Hungarisë Kral në Shkodër, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Shkodër, 18 prill 1916.

⁴ *Po aty*.

⁵ Fatmira Musaj, *Gruaja në Shqipëri (1912-1939)*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë: Tiranë: 2002, f. 97.

⁶ *HHSStA.PA.A*, në *AIH*, Vj. 26. 17. 1767. Relacion i konsullit të përgjithshëm Kral në Shkodër, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Shkodër, 18 prill 1916.

dhe fenë e saj.⁷ “Ato - theksonte ushtari Beaufils - nuk dalin aspak, për të shkuar edhe deri te burimi. Ndryshe nga gratë e reja, më të moshuarat nuk mbulohen.”⁸ Një zakon i tillë, kishte përcaktuar tek femrat edhe mënyrën e sjelljes së tyre në vendet publike. “Gratë me shami në kokë” - vazhdon ai- “ecin hijshëm nën vështrimin e burrave. Madje edhe vajzat adoleshente të veshura me fustane, zakoni e donte që ato të largonin me ndrojtje vështrimin para të huajve”.⁹ Në zonat ku francezët shkelën, konstatonin se si tek të krishterët dhe te myslimanët mbahej i njëjti qëndrim ndaj gruas, e cila konsiderohej si qenie inferiore.¹⁰

Gjendja e gruas shqiptare në vitet e Luftës së Parë Botërore, reflektoi të gjithë pasojat e veprimeve luftarake të një vendi në pushtim. Veçanërisht gruaja e zonave rurale, që zinte dhe përqindjen më të lartë të popullsisë femërore, u ndesh me një sërë vështirësish ekonomike e shoqërore të shkaktuara prej masave të marra nga komandat e ushtrive pushtuese. Kështu në zonën austro-hungareze, mobilizimi i burrave dhe djemve në kohën e mbjelljeve pranverore, për të punuar në objekte ushtarake dhe stërvitur për përdorimin e armëve; rekuizimi me forcë i bagëtive, veçanërisht therja e qeve dhe i prodhimeve bujqësore e blegtorale për nevojat e ushtrisë, ndikuan në mënyrë të drejtpërdrejtë në rëndimin e punës së gruas, e cila tashmë veç përballimit të punëve të shtëpisë, kishte plotësisht mbi shpatullat e saj edhe punët bujqësore e blegtorale.¹¹ Në këto kushte, ata i drejtoheshin Komandës së Përgjithshme austro-hungareze me thirrjen “mos na i merrni burrat dhe djemtë”, sepse të vetme nuk mund të përballonin punët e rënda të bujqësisë. Konsulli i Përgjithshëm, Kral në Shkodër, veprimet e komandës austro-hungareze, i shihte me pasoja të rënda ekonomike e sociale për popullsinë vendase. “Nëse nuk do të përjashtohet marrja e qeve për therje, informonte ai Vjenën zyrtare, atëhere nga fundi i vitit llogaritet një zi buke e pa parë”.¹² Shumë shpejt zija e bukës kërcënoi të gjithë vendin duke përfshirë familje të tëra, ku më e goditura ishte gruaja.

⁷ L. Rama. *Bonjour D'Albanie...*, f. 195.

⁸ *Po aty*,

⁹ *Po aty*, f. 207.

¹⁰ *Po aty*.

¹¹ *HSt.A.P.A.A.*, në *AIH*, Vj. 27. 9. 910. Relacioni konsullit të përgjithshëm Karl, për kontin Otokar Çzernin, Shkodër, 20 maj 1917.

¹² *Po aty*, Vj. 27.9.902, Relacion konsullit të përgjithshëm Kral në Shkodër për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Shkodër, mars 1917.

Asaj iu boshatis magjja e bukës dhe bulmeti, prodhimet bujqësore që ishin ushqimet bazë për fëmijët dhe familjen. Njëherësh situata e rënduar ekonomike shkaktoi rritje të pakënaqësisë e cila në disa zona verilindore degradoi deri në përplasje me armë midis popullsisë dhe forcave austro-hungareze.¹³ Përkeqësimi i gjendjes, rriti shqetësimin në Vjenë për rënien të ndikimit të saj në Shqipëri, çka bëri që autoritetet në kryeqytetin perandorak të merrnin masa të menjëhershme për përmirësimin e situatës në zonën e pushtimit. Në janar të vitit 1917, me anë të një Shpalljeje, ata i transmetuan shqiptarëve besimin që duhej të kishin në administratën ushtarake austro-hungareze, e cila kishte si qëllim të nxirrte popullin shqiptar nga prapambejtja, të përkrahte përparimin e tij ekonomik e kulturor dhe ta bënte atë politikisht të aftë për një regjim autonom.¹⁴

Për të lehtësuar krizën, autoritetet ushtarake mbështetën iniciativën e tregtarëve shqiptarë për çeljen e kuzhinave popullore për të vobektit, në Tiranë, në Elbasan dhe bënë thirrje që të tilla të hapeshin në të gjithë pjesën tjetër të administratës së tyre.¹⁵ Për kontributin e tregtarëve shqiptarë dhe mbështetjen financiare të tyre në ndihmë të të varfërve, komanda austro-hungareze ndau disa dekorata. Për herë të parë në Shqipëri u dekorua një grua, Marta Matia Tuka, anëtare e Komitetit të Zonjave.¹⁶

Veç kësaj, autoritetet austro-hungareze morën masa për shpërndarjen e ndihmave në ushqime, para e veshmbathje për të varfrit. Në këtë aktivitet, ata tërhoqën edhe gruan. Me iniciativën e zonjës së kryekonsullit Kral, në dhjetor të vitit 1916, u formua “Komiteti i Zonjave të Shkodrës” i cili u drejtua prej saj.¹⁷ Në këshillin provizor bënë pjesë bashkëshortet e konsullit Halla, të komandantit të ushtrisë Trollman dhe 9 gra myslimane e të krishtera të qytetit të Shkodrës. Qëllimi kryesor i komitetit ishte bamirësia. Në sajë të punës propaganduese të drejtuesve me gratë e qytetit, shumë shpejt u rrit baza sociale e tij dhe në qershor 1917 ai u organizua si një Komitet i Përhershëm. Këshilli drejtues me anë të një qarkore drejtuar grave të këtij qyteti, u bënte thirrje për t’u

¹³ *Po aty*, Vj. 17.17.1793, Raport i konsullit të përgjithshëm Kral në Shkodër, për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër 17 shtator 1917.

¹⁴ *Historia e popullit shqiptar*, vëll. 3, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 87.

¹⁵ *Posta e Shqypnisë*, nr. 24, 28 shkurt 1917, f. 3.

¹⁶ *Po aty*, nr. 52, 6 qershor 1917, f. 3.

¹⁷ *Po aty*, nr. 6, 23 dhjetor 1916, f. 4.

anëtarësuar, kundrejt një kuote prej tre koronash.¹⁸ Me ndihmat e siguruara nga qytetarët dhe atyre të ardhura nga Vjena, për afro dy vjet, Komiteti ndihmoi fëmijët e vobektë të shkollave të Shkodrës dhe qyteteve të tjera duke ua bërë të mundur vazhdimin e shkollës normalisht. Gjatë vitit 1917, me vajzat e shkollës Stigmatine, Komiteti vuri në skenë pjesë teatrale të cilat u shfaqën për nxënësit e shkollave dhe qytetarëve të Shkodrës. Për herë të parë u ngjiten në skenë vajzat dhe luajtën role të ndryshme, çka shënoi një hap para në rrugën e emancipimit e të zhvillimit të vajzës shkodrane. Paratë e grumbulluara u vunë në dispozicion të arsimit të fëmijëve.

Varfëria e skajshme, në kushtet e një lufte botërore, çoi në rritjen e prostitucionit në disa qytete shqiptare. Sipas të dhënave, vetëm në qytetin e Tiranës kishte 100 të tilla.¹⁹ Kjo e detyroi Komandën e Përgjithshme t'i vinte ato nën kontroll mjekësor për të mbajtur larg rrezikun e infektimit të ushtarëve nga sëmundjet veneriane.²⁰ Veç kësaj, për të parandaluar sëmundjet infektive dhe epidemitë në radhët e ushtrisë, ajo mori masa për të rritur higjienën dhe kujdesin shëndetësor duke ngritur në krahina të ndryshme, ambulanca e spitale dhe, sensibilizoi popullsinë vendase për pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të përbashkëta.

Ngritja e shërbimit shëndetësor për nevojat e ushtrisë, pati efekte pozitive edhe për popullsinë shqiptare, veçanërisht për gratë në radhët e të cilave vdekshmëria ishte më e lartë për shkak të varfërisë, paditurisë, punëve të rënda që përballonin, plagëve të shkaktuara nga lufta. Gjatë inspektimit të trupave franceze në fshatin Vizhdan të Korçës, doktori u njoftua për gjendjen e rëndë në të cilën ndodhej një grua, e cila ishte plagosur te burimi nga ushtritë ndërluftuese. Përpjekjet e mjekut për ta vizituar dhe për ta transportuar në spitalin provizor për mjekim më të specializuar, hasën në kokëfortësinë e burrit të saj. Për shkak të fanatizmit dhe mungesës së kulturës shëndetësore, ai preferonte që gruaja të qëndronte në atë gjendje se sa t'i zbulohej mjekut për ta vizituar.²¹

Në dokumentet e kohës dëshmohet kujdesi që Austro-Hungaria i kushtoi zhvillimit të një sistemi arsimor kombëtar në të gjithë zonën e administruar prej tyre. Në referatin e profesor Maks Myler kushtuar

¹⁸ *Po aty*, nr. 52, 6 qershor 1917, f. 3.

¹⁹ *HHSt.A.PA.A. në AIH*, Vj. 27.9. 902. Relacion i konsullit Halla në Shkodër, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Shkodër, mars 1917.

²⁰ *Po aty*.

²¹ L. Rama, *Bonjour D'Albanie...*, f. 213-214. Nga ditari i ushtarit J. L. Beaufils.

zhvillimit të arsimit në Shqipëri, përgatitur për Ministrinë e Punëve të Jashtme, theksohej se “.....mbështetja që i është dhënë shqiptarizimit të klerit katolik dhe shkollave të tij qysh në vitin 1897, tani duhej zbatuar në të gjithë shkollat e Shqipërisë”.²² Gjithashtu, profesori i sugjeronte Vjenës, se “...arsimi modern në Shqipëri duhet të jetë mjete ose vendi ku rinia të edukohet për punë pozitive dhe për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare, ku të gjithë të mësojnë se janë pjestarë të një kombi”.²³ Rritjen e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve, autoritetet e larta vjeneze e shihnin si mjetin më të mirë që do t’i shërbente politikës së madhe austro-hungareze, për të mbajtur larg sllavët në veri dhe italianët në jug.

Masat që u morën për zhvillimin e arsimit kombëtar, patën ndikim pozitiv në përmirësimin e gjendjes arsimore të femrës. Në administratën civile u krijua drejtoria arsimore, i cila drejtohej nga Luigj Gurakuqi, personalitet me përvojë në këtë fushë. Për të bërë të mundur frekuentimin e shkollës nga vajzat, për shkak të konservatorizmit dhe fanatizmit, sistemi arsimor që u ngrit, pati të njëjtën strukturë si ai i qeverisë së përkohshme të Vlorës. Shkollat për vajza, krahas atyre për djem, do të bënin të mundur tërheqjen e një numri më të madh të vajzave. Sipas statistikës së drejtorisë arsimore për vitin shkollor 1916-1917, në Shqipëri funksiononin 200 shkolla.²⁴ Këtë vit ishin çelur shkollat fillore femërore në qytetet, Shkodër, shkolla Stigmantine si dhe dy shkolla fillore publike të çelura rishtaz, një në Krujë, dy në Tiranë dhe një në Berat.²⁵ Gjithashtu në zonën e pushtimit francez u rihap shkolla e “Vashave” në Korçë²⁶, një shkollë për vajza në Pogradec, ndërsa në zonën italiane filloi të funksionojë shkolla femërore në qytetin e Vlorës.²⁷ Për të siguruar pjesëmarrjen sa më të gjërë të fëmijëve u nxor ligji mbi detyrimin shkollor si për vajza e për djem, nga mosha 7 deri në 12 vjeç.²⁸

²² *HHSt.A.P.A.A. në AIH, Vj. 27.1. Referat mbi zhvillimin e shkollave në Shqipëri, Vjenë 1917.*

²³ *Po aty, Vj. 26.3.396; E ardhmja e Shqipërisë. Konsiderata-refleksione teorike-propozime praktike, përgatitur nga profesor Maks Myler, Mynih: 1916.*

²⁴ *Posta e Shqypnisë, nr. 49, 26 maj, 1917, f. 1.*

²⁵ *HHSt.A.P.A.A. në AIH, Vj. 27.1.108. Raport mbi zhvillimin e arsimit, Shkodër, 17 qershor 1917.*

²⁶ *Kujtime të grave veterane, përgatitur për botim nga Petraq Pepo, Tiranë: Mihal Duri, 1962, f. 68.*

²⁷ F. Musaj, *Gruaja në Shqipëri...*, f. 97.

²⁸ *HHSt.A.P.A.A. në AIH, Vj. 27.1.110. Organizimi provizor i arsimit në Shqipëri, Shkodër, 17 qershor 1917.*

Mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe si gjuhë e parë dhe si gjuhë e dytë ishte gjermanishtja. Kjo sipas autoriteteve austro-hungareze, do të rriste nacionalizmin te shqiptarët dhe do të largonte italishten që dikur ishte përkrahur prej tyre. Programi në shkollat fillore në qytete afronte me atë të tipit perëndimor, ndërsa për shkollat e fshatit të cilat ishin më të vogla nuk pretendohesh një gjë e tillë.²⁹ Para fillimit të mësimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të tjera jashtëshkollore duhej të këndohej hymni kombëtar shqiptar.³⁰ Nisur nga frekuentimi i dobët i shkollës nga vajzat për shkak të konservatorizmit dhe fanatizmit, kryekonsulli Kral, në shkurt të vitit 1917, në fjalimin e mbajtur para nxënësve dhe prindërve të shkollës popullore të Rusit në Shkodër, nënvizoi nevojën e rëndësishme të shkollimit në gjuhën amtare të vajzave e të djemve dhe detyrën që kishin prindërit për t'i dërguar fëmijët e të dy gjinive në shkollë. Në fund të fjalimit ai i ftoi të pranishmit të brohorisnin tre herë “rrroftë shkolla shqipe”.³¹

Mungesa e mësueseve në shkolla ishte një ndër faktorët e frekuentimit të dobët të tyre nga vajzat. Për këtë, autoritetet austro-hungareze në Shkodër dërguan 14 vajza në Austri për të studiuar për mësuesi, të cilat u mbështetën financiarisht, pjesërisht nga arka shqiptare dhe pjesërisht nga familjet.³²

Në qytetin e Shkodrës u çel dhe një shkollë e re e arsimit profesional për vajza. Ato do të mësonin zanate të ndryshme si qëndistari e punime të tjera, të cilat do t'u shërbenin për përmirësimin e ekonomisë familjare. Fillimisht u regjistruan 9 vajza që u përkisnin të dy besimeve fetare. Shtatë prej tyre ishin të besimit katolik dhe dy ishin myslimane.³³ Baza materiale e kësaj shkolle dhe shkollave të tjera për vajza, sigurohej dhe subvencionohej nga Vjena.³⁴

Gruaja me punën e dorës, si në endje të pëlhurave, të përpunimit të leshit dhe prodhimeve të tij në endje të sixhadeve dhe qilimave, në qëndistari me fije mëndafshi, ar dhe argjend, jepte kontribut jo vetëm në ekonominë e familjes por dhe në të ardhurat e ekonomisë kombëtare. Veç kësaj vlere e rëndësia e kësaj pune të palodhur, qëndronte në atë të ruajtjes dhe përçarjes ndër breza të kulturës dhe etnografisë popullore

²⁹ *Po aty*, Vj. 27.1. Referat mbi veprimin e shkollave në Shqipëri, Vjenë, 1917, fl 8.

³⁰ *Po aty*, fl. 14; *Posta e Shqypnisë*, nr.18, 7 shkurt 1918, f. 3.

³¹ *Posta e Shqypnisë*, nr.18, 7 shkurt 1918, f. 3.

³² *Po aty*, nr. 90, 17 tetor 1917, f. 3.

³³ *Po aty*, nr. 75, 25 gusht 1917, f. 3.

³⁴ *Po aty*.

shqiptare. Për të propoganduar punën e mjeshtëreshave të Shqipërisë autoritetet austro-hungareze organizuan grumbullimin e punëdoreve më të bukura të punuara prej tyre, e i dërguan në Vjenë për t'i paraqitur në ekspozitën ballkanike, që u hap më 16 janar 1918.³⁵ Në paraqitjen e punimeve nga Shqipëria foli profesor Himberband. Midis përshtypjeve tërheq vëmendjen vlerësimi i një shkrintari austriak, ku midis të tjerave thuhet “Këto punime të bukura që di të kryejë dora e censhme shqiptare, megjithëse e pa shkollë, do të mjaftonin, për të na dëshmuar se populli juaj, pavarësisht asaj çka ka pësuar, në gjithçka meriton një çmim të madh”.³⁶

³⁵ “Punëdoret e Shqipërisë” në *po aty*, nr. 99, 17 nëntor 1917, f. 3; *po aty*, nr. 8, 5 janar 1918; “Mbi ekspozitën e punimeve të dorës nga Shqipëria” në *po aty*, nr. 11, 16 janar 1918, f. 4.

³⁶ *Po aty*.